



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Analiza epidemiologjike vjetore (Pasqyra 14 Sh)

ANALIZA EPIDEMIOLOGJIKE VJETORE

2017

Analiza epidemiologjike e sëmundshmërisë infektive për vitin 2017 ne Shqipëri bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të vendit tonë, të raportuara nga Shërbimet e Epidemiologjisë të Rretheve në DEKSI (Departamenti i Epidemiologjisë dhe i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, ISHP). Të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), janë të raportuara përmes pasqyrës mujore 14/Sh e cila përbën burimin kryesor të të dhënave mbi të cilat mbështetet analiza epidemiologjike e sëmundjeve infektive ne Shqipëri. Gjatë analizës epidemiologjike të sëmundshmërisë infektive për vitin 2017 janë paraqitur një përmbledhje të të gjitha nozologjive të përfshira në Pasqyrën 14 Sh.

Analiza epidemiologjike vjetore është ndërtuar duke i analizuar sëmundjet infektive të grupuara në kapituj sipas natyrës së tyre.

Shefe Departamentit të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive As. Prof. Silvia Bino

- | | |
|--|---------------|
| 1. Sëmundjet diarreike | Rovena DAJA |
| 2. Hepatite virale akute | Elona Kureta |
| 3. Gripi dhe Common Cold | Artan Simaku |
| 4. Fruthi dhe Rubeola | Artan Simaku |
| 5. PFA | Artan Simaku |
| 6. Difteria | Artan Simaku |
| 7. Tetanozi dhe tetanosi neonator | Artan Simaku |
| 8. Pertus | Artan Simaku |
| 9. Parotiti epidemik | Artan Simaku |
| 10. Varicela | Artan Simaku |
| 11. Infeksionet streptokoksike | Artan Simaku |
| 12. Meningiti Meningokoksik dhe Meningitet e tjera | Eugena Tomini |

13. Encefaliti i paspecifikuar	Eugena Tomini
14. Ethet Hemorragjike Virale	Eugena Tomini
15. Zoonozat	Luljeta Alla
16. TBC ekstrapulmonar	Luljeta Alla
17. Rikeciet	Luljeta Alla
18. Semundjet seksualisht te trasmetueshme	Adela Vasili
19. HIV/AIDS	Marjeta Dervishi
20. Leishmania viscerale	Adela Vasili

1. Sëmundjet Diarreike

Në këtë kapitull janë përfshirë të gjithë rastet e raportuara nga shërbimet epidemiologjike të rretheve, me sëmundje diarreike, sipas Pasqyrës 14/Sh që përben burimin kryesor të të dhënave për sëmundjet infektive, gjatë periudhës 2016-2017. Të dhënat janë analizuar dhe janë përpunuar në grafikë dhe tabela në Excel. Grupi B (Pasqyra 14 Sh) përmban 48 entitete nozologjive. Në këtë grup përfshihen edhe **sëmundjet diarreike** të cilat shërbimi mjekësor klinik i rrethit i raporton në shërbimin epidemiologjik, i cili plotëson Pasqyrën 14 Sh dhe skedat individuale epidemiologjike. Në sëmundjet diarreike përfshihen gjashtë nozologji: **tifo abdominale dhe paratifo, salmonelozat jotifoide, shigelozat, dizenteri amebike, toksikoinfeksionet alimentare dhe gastroenteritet** (Grupi C). Përshkrimi i situatës epidemiologjike të sëmundjeve diarreike është bërë duke përqendruar vëmendjen e veçantë në:

1. Përshkrimin e trendit të tyre gjatë vitit 2017
2. Shpërndarjen e sëmundjeve diarreike sipas moshës
3. Shpërndarja e sëmundjeve diarreike sipas rretheve
4. Shpërndarja e sëmundjeve diarreike sipas muajve


Incidenca e sëmundjeve diarreike, të marra në grup është 3166.92/100.000 banorë në vitin 2017.

Tabela 1: Sëmundjet diarreike në 2017 (Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste 2017	Incidenca 2017
Tifo abdominale + Paratifo	3	0.11
Salmonelozat	427	15.25
Shigelozat (Dizenteri bacilare)	395	14.11
Dizenteri amebike	3	0.11
Toksikoinfeksione alimentare	2199	78.53
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	85651	3058.81
Sëmundje diarreike në total	88675	3166.92


Në vitin 2017 sëmundjet diarreike përbejnë 39.7% të totalit të Sëmundshmerisë Infektive vjetore dhe në grupin e sëmundjeve diarreike 96,5% të tyre e zënë gastroenteritet e paspecifikuara.

Grafiku 1



Gastroenteriti i paspecifikuar zë peshën specifike kryesore me 96.5% të totalit të rasteve të raportuara me sëmundje diarreike më 2017 pasuar nga toksikoinfeksionet alimentare (2.48% e totalit të sëmundjeve diarreike), Salmonelozat jo-tifoide (0,48% e totalit të sëmundjeve diarreike), Shigeloza (0,45% e totalit të sëmundjeve diarreike). Dizanteria Bacilare (0,003% e totalit të sëmundjeve diarreike) dhe tifo abdominale dhe paratifo (0,003% e totalit të sëmundjeve diarreike) Pësha specifike tepër e lartë e gastroenteritit të paspecifikuar në raportimin e sëmundjeve diarreike lidhet me nivelin e ulët të konfirmimit mikrobiologjik të rastit në nivel rrethi, rrjedhë e nivelit të ulët të performancës së aktivitetit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik të rretheve në drejtim të diagnozës bakteriologjike dhe parazitare të infeksioneve/sëmundjeve diarreike. Shpërndarjen e frekuencës të sëmundjeve diarreike sipas grup-moshave (në përqindje ndaj totalit vjetor të rasteve) e paraqesim në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 2




Rastet me të shumta u përjasin grup-moshave foshnjore e fëmijore. Konkretisht, moshat 0-1 vjeç paraqesin rreth 7.3% dhe ato 1-4 vjeç rreth 20.5% të tërë rasteve vjetore me sëmundje diarreike. Apo, në total, moshat 0-4 vjeç përbejnë rreth 27.9% të të gjitha rasteve vjetore me sëmundje diarreike. Ky fakt tregon qartë rolin vendimtar që

luan ne radhe te pare ne vendin tone niveli i pamjaftueshëm i kulturës higjienike-shëndetësore te nënës, nivel ky qe ka mundësi te ketë lidhje lineare (te drejtpërdrejte) me nivelin arsimor. Lind nevoja e riparimit te një mangësie te tille: parandalimi parësor nëpërmjet strategjive dhe taktikave te ndërtuara shkencërisht te edukimit dhe promovimit shëndetësor. Vendin e trete ne frekuencën sipas moshave te sëmundjeve diarreike e zënë moshat 5-14 vjeç, me rreth 24.9% te tere rasteve vjetore. Vlen te theksojmë qe jemi ende ne moshat fëmijore, ku përsëri roli i nënës është kryesor. Vihet re një ulje e qëndrueshme dhe statistikisht sinjifikative te frekuencës te sëmundjeve diarreike me rritjen e moshave: qe ulet nga rreth 11.17 % ne grup-moshën 15-24 vjeç ne 8.7 % ne grup-moshën 25-34 vjeç.


Incidencat e sëmundjeve diarreike sipas rretheve për vitin 2017 paraqiten ne grafikun e mëposhtëm. Disa rrethe paraqiten me një risk me te larte te hasjes. Te tilla janë: Tropoja, Bulqiza, Durrësi etj.

Grafiku 3



Frekuenca e hasjes të sëmundjeve diarreike gjatë vitit vazhdon të paraqesë karakterin e mirënjohur stinor me mbizotërimin e theksuar të rasteve në stinën e nxehtë. Frekuenca e hasjes rritet në Qershor, Korrik për të arritur kulmin e vet në muajin Gusht.

Grafiku 4




1.1 Tifo Abdominale dhe Paratifo

Tifo abdominale dhe paratifo paraqesin një incidence të ulët në Shqipëri, me ulje dhe me ngritje në vite. Në vitin 2017 kemi vetëm tre raste të konfirmuara në Tiranë. Rastet janë të grup-moshave të ndryshme.

1.2. Salmonelozat jotifoide


Salmonelozat vijojnë të përbejnë problem: incidence 15.25/100.000 banorë në 2017. Salmonelozat jo-tifoide përbejnë në 2017, 0,48% e totalit të sëmundjeve diarreike. Shkoder është rrethi më problematik me numrin më të lartë të rasteve të konfirmuara me laborator me Salmonelozat jotifoide pasuar nga Dibra dhe Tirana.

Grafiku 5




Rastet me te shumta u përkasin grup-moshave foshnjore dhe feminare: 0-4 vjeç dhe 5-9 vjeç. Ky fakt tregon qarte rolin vendimtar qe luan ne radhe te pare ne vendin tone niveli i pamjaftueshëm i kulturës higjienike-shëndetësore te nenës.

Grafiku 6



Frekuenca e hasjes të salmonelozes jotifoide gjatë vitit vazhdon të paraqesë karakterin e mirënjohur stinor me mbizotërimin e theksuar të rasteve në stinën e nxehtë. Frekuenca e hasjes rritet në Qershor, Korrik, Gusht.


Grafiku 7



1.3. Shigeloza

Incidenca e shigelozes paraqet rënie nga viti 2016 ne vitin 2017. Shigeloza ne vitin 2017 përbën 0.45% te totalit te sëmundjeve diarreike. Rastet me te shumta u përkasin grup-moshave foshnjore dhe feminare: 0-4 vjeç dhe 5-9 vjeç. Ky fakt tregon qarte rolin vendimtar qe luan ne radhe te pare ne vendin tone niveli i pamjaftueshëm i kulturës higjienike-shëndetësore te nenës.

Grafiku 8



Vihet re qe ne mënyre te qëndrueshme paraqet një frekuence te larte te shigelozes Shkodra, Tirana dhe Kukës për vitin 2017. Megjithatë ne Tirane vëmë re një ulje te madhe te rasteve te konfirmuara me Shigeloze për vitin 2017 duke e krahasuar me vitet e tjera dhe kjo ndoshta lidhet me nen raportimin.

Grafiku 9



Rastet me Shigeloze janë te shpërndara gjate gjithë vitit ashtu siç paraqiten ne grafikun e mëposhtëm.


Grafiku 10



1.4 Toksoinfeksionet alimentare

Incidenca e toksikoinfeksioneve alimentare ne 2017 është 78.53/100.000 banore. Toksikoinfeksionet alimentare përbejnë 2.48% te totalit te sëmundjeve diarreike ne vitin 2017. Ndoshta numri i tyre mund te jete edhe me i larte por në shume raste ato ne shërbimin ambulator diagnostikohen nen emërtimin gastroenterite. Kjo shpjegon edhe faktin pse kemi një numër te larte te gastroenteriteve. Incidenca e toksikoinfeksioneve alimentare eshte me e larte ne grup-moshen 0-4 vjec dhe 5-9 vjec sic jane edhe ne pergjithesi te gjitha semundjet diarreike.

Grafiku 11



Frekuenca e hasjes të toksikoinfeksioneve alimentare gjatë vitit vazhdon të paraqesë karakterin e mirënjohur stinor me mbizotërimin e theksuar të rasteve në stinën e nxehtë. Frekuenca e hasjes rritet në Qershor, Korrik për të arritur kulmin e vet në muajin Gusht dhe Shtator.

Grafiku 12



Numrin me te madh te rasteve te raportuara me Toksikoinfeksione alimentare e ka Bulqizë, Kukës, Berati dhe Tirana. Kjo është një situatë që ndodh çdo vit për faktin se në këto rrethe shpesh here vendoset kjo diagnozë nga mjeku klinikist për pacientet që kanë qofte edhe vetëm një episod “diarre pa gjak”


Grafiku 13



1.5 Gastroenteritet e paspecifikuara


Në grupin e sëmundjeve diarreike 96.5% të tyre e zënë gastroenteritet e paspecifikuara për vitin 2017. Incidenca e gastroenteriteve në vitin 2017 është 3166.92/100.000 banorë. Incidencën më të lartë e gjejmë në grup-moshën 0-4 vjeç sepse kjo është moshë që preket më tepër. Peshë specifike tepër e lartë e gastroenteritit të paspecifikuar në raportimin e sëmundjeve diarreike lidhet me nivelin e ulët të konfirmimit mikrobiologjik të rastit në nivel rrethi, rrjedhojë e nivelit të ulët të performancës së aktivitetit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik të rretheve në drejtim të diagnozës bakteriologjike dhe parazitare të infeksioneve/sëmundjeve diarreike.

Grafiku 14



Frekuenca e hasjes të gastroenteriteve te paspecifikuara gjatë vitit vazhdon të paraqesë karakterin e mirënjohur stinor me mbizotërimin e theksuar të rasteve në stinën e nxehtë. Frekuenca e hasjes rritet në Qershor, Korrik për të arritur kulmin e vet në muajin Gusht dhe Shtator

Grafiku 15



Perfundime;

Sëmundjet Diarreike mund të parandalohen duke ndjekur nje përqsaje multisektoriale:

1. Monitorimi i pandërprere i faktorëve risk të Shëndetit Mjedisor dhe të kontrollit të sigurisë ushqimore
2. Sigurimi i furnizimit me ujë të pastër brenda parametrave higjeno-sanitare
3. Inspektimi sanitar i produkteve ushqimore dhe i kushteve në të cilat realizohet prodhimi dhe tregtimi i tyre
4. Menaxhimi sanitar i mbetjeve urbane dhe ujerave te zeza
5. Parandalimi dhe kontrolli i shpërthimeve epidemike
6. Promovimi i edukimit shëndetësor mbi higjienën vetjake dhe komunitare.

2. Hepatite virale akute ne Shqipëri për vitin 2017

(Te dhëna nga tabela 14-SH e semundshmerise infektive)

Ne raportimin mujor te semundshmerise infektive gjate vitit 2017 janë raportuar ne total 235 raste me hepatite virale akute nga te cilat 117 (49.8 %) raste janë Hepatite virale te paspecifikuar, 17 (7.2 %) raste me Hepatit viral A (HAV), 83 (35.3 %) raste me Hepatit viral akut B (HBV) dhe 18 (7.7 %) raste me hepatit viral akut C (HCV).(tabela1)

Tabela 1. Numri total i rasteve te raportuara me hepatite virale akute 2017

Viti	Hepatiti viral I paspecifikuar		HAV		HBV		HCV	
	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca
2017	117	4.18	17	0.61	83	2.96	18	0.64

Tabela2. Shpërndarja e rasteve sipas grupmoshës, Incidenca (raste/10000 banore) 2017

Grupmosha,vite	Hepatit I paspecifikuar		HAV		HBV		HCV	
	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca
>1	3	0.83		0				
1-4	9	0.71	1	0.08				0
5-14	30	0.72	5	0.12		0		0
15-24	17	0.33	3	0.06	9	0.18	4	0.08
25-44	27	0.38	4	0.06	46	0.65	8	0.11
45-59	17	0.31	1	0.02	17	0.31	5	0.09
60+	14	0.31	3	0.07	12	0.27	1	0.02

Siç vihet re edhe nga tabela 2, grupmosha pediatrike ka numrin dhe incidence me te larte për dy llojet e hepatiteve virale përkatësisht Hepatiti viral i paspecifikuar dhe Hepatiti viral A. Ndërsa për HBV dhe HCV numri me i larte vërehet ne grupmoshat e rritura qe janë edhe me aktive. Mungesa e rasteve ne grupmoshat pediatrike për HBV është e lidhur me vaksinimin qe ne lindje sipas kalendarit kombëtar te vaksinimit.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve me hepatite virale akute sipas gjinisë,2017


Lloji i hepatitit viral	Meshkuj		Femra	
	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca
Hepatiti I paspecifikuar	73	0.52	44	0.31
Hepatit viral A	13	0.08	6	0.04
Hepatit viral B	53	0.38	31	0.22
Hepatit viral C	13	0.09	5	0.04

Nga tabela 3 vërehet se për te katër tipat e hepatiteve virale numri me i larte i raportuar është te meshkujt krahasuar me femrat.

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve dhe incidence sipas rretheve


Rrethe	2017							
	HEP.I PASPEC		HAV		HBV		HCV	
	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca	Raste	Incidenca
Berat	2	0.20	3	0.3	1	0.1	2	0.20
Bulqize	8	2.56		0.0		0.0		0.00
Delvine		0.00		0.0	2	1.7		0.00
Devoll		0.00		0.0		0.0		0.00
Diber	25	4.06		0.0		0.0		0.00
Durres	2	0.10	1	0.0	12	0.6	3	0.15
Elbasan	3	0.16		0.0	6	0.3	2	0.11
Fier		0.00		0.0	4	0.2	2	0.12
Gramsh	2	0.83	1	0.4		0.0		0.00
Gjirokaster		0.00		0.0	2	0.6		0.00
Has		0.00		0.0		0.0		0.00
Kavaje		0.00		0.0		0.0		0.00
Kolonje		0.00		0.0		0.0		0.00
Korce		0.00		0.0		0.0		0.00
Kruje	7	1.17		0.0		0.0		0.00
Kucove		0.00		0.0	18	6.6	2	0.73
Kukes	21	4.38		0.0		0.0		0.00
Lac	1	0.22		0.0		0.0	1	0.22
Lezhe	10	1.52	1	0.2		0.0		0.00
Librazhd	3	0.53		0.0		0.0		0.00
Lushje	5	0.42	5	0.4		0.0		0.00
M.Madhe		0.00		0.0		0.0		0.00
Mallakaster	9	3.33	2	0.7		0.0		0.00
Mat		0.00		0.0	1	0.2		0.00
Mirdite	1	0.45		0.0		0.0		0.00
Peghin	1	0.38		0.0	4	1.5		0.00
Permet		0.00		0.0	1	0.6		0.00
Pogradec	8	1.30		0.0	3	0.5		0.00
Puke		0.00		0.0		0.0		0.00
Sarande	1	0.26		0.0		0.0		0.00
Skrapar		0.00		0.0	1	0.6		0.00
Shkoder	7	0.42		0.0	1	0.1	2	0.12
Tepelene		0.00		0.0	1	0.5		0.00
Tirane	1	0.01	4	0.1	21	0.3	4	0.06
Tropoje		0.00		0.0		0.0		0.00
Vlore		0.00		0.0	6	0.5		0.00
Total	117	0.42	17	0.1	83	0.3	18	0.06

Grafiku 3. Shperndarja e rasteve sipas rretheve Hepatit viral i paspecifikuar




Rrethet që kanë raportuar me tepër raste me këtë lloj hepatiti viral gjatë 2017 janë Kukës, Pogradeci, Mallakastër, Diber, Bulqizë ndjekur nga Gramsh, Saranda, Shkodra.

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve sipas rretheve të HAV



Duhet theksuar se numri i raportuar me HAV është i ulët për shkak të mungesës së kapaciteteve laboratorike. Rastet për vitin 2017 janë raportuar nga rrethi i Mallakastres, Lushnjë, Berat, Gramsh, Lezhë, Durrës dhe Tiranë. Nga hetimi epidemiologjik të gjitha rastet e raportuar kanë qenë sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre.

Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve sipas rretheve i HBV

Rrethi i Kuçovës siç shihet edhe ne grafik ka raportuar numrin me te larte te rasteve për vitin 2017. Pas saj vjen Delvina, Peqini, Gjirokastër dhe Vlore. Incidenca ne këto rrethe është me e larte duke pasur parasysh edhe numrin e popullatës se tyre si dhe forcimit te survejances .

Edhe për HCV rastet janë raportuar nga Kucova, Berati, Shkodra, Durrësi, Elbasani Fieri, Laçi dhe Tirana.

Nga hetimi epidemiologjik i kryer për te gjitha rastet me hepatite virale ka rezultuar se janë raste sporadike pa lidhje epidemiologjike mes tyre. Edhe gjate vitit 2017 nuk ka patur shpërthime epidemike nga hepatitet virale ne vend.

3. Gripi dhe Common Cold

Infeksionet respiratore zenë peshën specifike më të madhe në sëmundshmërinë e përgjithshme infektive në vendin tonë

Gripi dhe Common Cold shtjellohen së bashku sepse janë të ngjashëm klinikisht. Shpesh herë Common Cold diagnostikohet klinikisht për Grip dhe raportohet si i tillë, (e anasjellta ka më pak gjasë), si dhe janë ata, që përfaqësojnë në Pasqyrën 14/Sh infeksionet respiratore.

Frekuenca e hasjes së gripit ndjek ecurinë e mirënjohur stinore të tij: “stina e gripit” fillon rreth muajit nëntor për të përfunduar rreth muajit mars-prill të vitit pasardhës.

GRIPË

Nr. i rasteve sipas viteve dhe incidenca (raste/100000)

Viti	Raste	Raste/100000
2017	36907	1318.0

Frekuenca e hasjes së Gripit paraqet incidence prej 1318.0 raste/100.000 banorë ne vitin 2017.

“Stina e gripit” është stina e ftohtë e vitit, periudha Janar-Prill, e cila filluesën e saj e ka në muajin Nëntor/Dhjetor të vitit paraardhës. Piku i hasjes së Gripit është ne Mars dhe për Common Cold është muaji Shkurt.

Gripi. N. i rasteve dhe incidencia (raste/10000) sipas rretheve

Rrethet	2017	
	Raste	Incidenca
Berat	645	65.9
Bulq	719	230.4
Delvine	267	227.9
Devoll	674	252.3
Diber	1938	314.5
Durres	30	1.5
Elbasan	11	0.6
Fier	1074	65.0
Gramsh	270	111.4
Gjirokaster		0.0
Has	576	343.1
Kavaje	2500	431.7
Kolonje	675	609.8
Korce	3232	267.0
Kruje		0.0
Kucove	526	192.8
Kukes	1767	368.2
Kurbin	139	30.0
Lezhe	397	60.5
Librazhd	1189	209.3
Lushnje	894	75.8
M.MAdhe	246	79.8
Mallakaster		0.0
Mat	496	112.2
Mirdite	2145	970.5
Peqin	1497	572.8
Permet	511	305.5
Pogradec	152	24.7
Puke	1062	574.9
Sarande	194	51.3
Skrapar	1164	696.1
Shkoder	3044	183.3
Tepelene		0.0
Tirane	5149	74.5
Tropoje	3028	1475.8
Vlore	702	55.7

Numri i rasteve dhe incidenca e Gripit sipas gjinise

Viti	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2017	18933	1349.4	17974	1286.5

Nuk verehet ndryshim i hasjes se gripit sipas gjinisë. Te dy gjinitë preken pothuajse njësoj nga gripi.

Numri i rasteve dhe incidenca e Gripit sipas grupmoshës (2017)

	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
Nr. rasteve me Grip	2185	5720	8355	3907	6630	5216	4894
Incidenca	936.9	725.3	315.5	105.9	94.6	87.9	89.6

Shpërndarja e frekuencës së hasjes së Gripit dhe Common Cold sipas grup-moshave tregon se peshën specifike kryesore në sëmundshmëri e tyre e mbajnë grup-moshat pediatrike

0-14 vjeç. Incidencën më të lartë në brendi të tyre e paraqet grup-mosha <1 vjeç, e ndjekur nga grup-moshat 1-4 vjeç dhe 5-14 vjeç, Infeksionet respiratore vazhdojnë të mbeten shkaku kryesor i vdekshmërisë foshnjore (<1 vjeç) dhe asaj fëmijënore (1-4 vjeç) në vendin tonë.

COMMON COLD**Nr. i rasteve sipas viteve dhe incidenca (raste/100000)**

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	93100	3324.8

Frekuenca e hasjes së Common Cold paraqet një nivel incidence prej 3324.8raste/100.000 banorë ne vitin 2017

Common cold Nr. i rasteve dhe incidenca sipas rretheve (raste/10000)

Rrethet	2017	
	Raste	Incidenca
Berat	8562	874.2
Bulq	290	92.9
Delvine		0.0
Devoll	498	186.4
Diber		0.0
Durres	674	33.2
Elbasan	13	0.7
Fier	36846	2228.3
Gramsh	62	25.6
Gjirokaster		0.0
Has		0.0
Kavaje	0	0.0
Kolonje	39	35.2
Korce	2472	204.2
Kruje	1065	178.1
Kucove	202	74.0
Kukes		0.0
Kurbin	658	142.1
Lezhe	631	96.1
Librazhd	888	156.3
Lushnje	5376	455.9
M.MAdhe		0.0
Mallakaster		0.0
Mat	2628	594.3
Mirdite	922	417.1
Peqin	528	202.0
Permet		0.0
Pogradec	4	0.7
Puke		0.0
Sarande	44	11.6
Skrapar		0.0

Shkoder		0.0
Tepelene	2423	1235.8
Tirane	24912	360.3
Tropoje		0.0
Vlore	3363	266.6

Numri i rasteve dhe incidenca e Common cold sipas gjinise

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2017	49261	3511.0	43839	3137.9

Nuk vërehet ndryshim i hasjes se C. cold sipas gjinisë. Te dy gjinitë preken pothuajse njësoj.

Numri i rasteve dhe incidenca e Common cold sipas grupmoshes (2017)

	<1vjec	1-4 vjec	5-14 vjec	15-24 vjec	25-44 vjec	45-59 vjec	60+ vjec
Nr. rasteve me C. cold	8345	26324	28719	9234	11450	6642	5736
Incidenca	2311.7	2066.3	691.9	180.2	161.3	120.5	128.0

4. FRUTHI DHE RUBEOLA

Viti 2001 shënoi fillimin në vendin tonë të fazës epidemiologjike për eliminimin e fruthit dhe rubeolës si infeksione indigjene në popullatë. Njëlloj sikurse për poliomielin, kjo situatë epidemiologjike dikton domosdoshmërinë e mbajtjes në vijueshmëri të pandërprerë njëherësh të niveleve >95% të mbulesës vaksinore kundrejt fruthit dhe rubeolës si në shkallë vendi, si në shkallë rrethi, ashtu (dhe sidomos) dhe në nivel “kapilar” (fshat, lagje/bllok në qytet, etj), si edhe të Survejancës së përfunduar të Bazuar-në-Rast të Fruthit/Rubeolës (me konfirmim të detyrueshëm laboratorik të rastit të dyshuar klinikisht), aplikimi i së cilës filloi më 1 janar 2002.

FRUTH

Nr. i rasteve sipas viteve dhe incidenca (raste/100000)

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	12	0.4

Ne vitin 2006 ndodhi një shpërthim me 68 raste të konfirmuara i cili u përhap kryesisht në komunitetin Rom në disa rrethe të vendit. Nga hetimi epidemiologjik rezultoi që rasti i parë i këtij shpërthimi (Indeks case) ishte importuar nga Greqia.

Ne vitin 2007 ndodhi një shpërthim tjetër me 22 raste të konfirmuara në komunitetin Rom dhe fëmijë nga zona të thella rurale. Nga hetimi epidemiologjik rezultoi që rasti i parë i këtij shpërthimi (Indeks case) ishte importuar nga Italia.

Ne periudhën kohore 2008-2016 nuk janë hasur raste me fruth në vendin tonë.

Në Nëntor të vitit 2017 u shfaq një shpërthim epidemik i fruthit në Pogradec i importuar nga Maqedonia dhe Kosova në një komunitet Rom me 9 raste, ku vaksinimi masiv i komunitetit Rom në të gjithë rrethin si dhe vaksinimet suplementare të fëmijëve të prapambetur e të tjerë e eliminuan shpërthimin e mëtejshëm në këtë rreth.

Fruth Nr. i rasteve dhe incidenca (raste/10000) sipas rretheve

Rrethet	2001	
	Raste	Incidenca
Berat		
Bulq		
Delvine		
Devoll		
Diber		
Durres		
Elbasan		
Fier	1	0.1
Gramsh		
Gjirokaster		
Has		
Kavaje		
Kolonje		
Korce		
Kruje		
Kucove		
Kukes		
Kurbin		
Lezhe	1	0.2
Librazhd		
Lushnje		
M.MAdhe		
Mallakaster		
Mat		
Mirdite		
Peqin		
Permet		
Pogradec	9	1.5
Puke		
Sarande		
Skrapar		
Shkoder		
Tepelene		
Tirane		
Tropoje		
Vlore	1	0.1

Rastet e Lezhes te Fierit dhe te Vlores jane te importuara perkatesisht nga Italia, Greqia dhe Kosova.

Numri i rasteve dhe incidenca e Fruthit sipas gjinisë per vitin 2017.

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2017	4	0.3	8	0.6

Numri i rasteve dhe incidenca e Fruthit sipas grupmoshës (2017)

	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
Nr. rasteve me Fruth	1	3	5	1	1	1	0
Incidenca	2.8	2.4	1.2	0.2	0.1	0.2	0

RUBEOLA

Nr. i rasteve sipas viteve dhe incidenca (raste/100000)

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	0	0.00

5. PFA

Nr. i rasteve sipas viteve dhe incidenca (raste/100000) për vitin 2017.

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	7	0.2

Numri i rasteve vjetore te pritshme me PFA është 9, dmth 1 rast PFA në 100.000 popullatë të moshave pediatrike 0-14 vjeç, popullatë kjo që përlogaritet aktualisht në vendin tonë në <900.000 subjekte), çka përfaqëson një indeks prej 0.9 të asaj survejance.

Survejanca e PFA-ve më 2016 ka realizuar JO-PLOTËSISHT parametrat (indikatorët) e saj sepse janë raportuar 8 raste nga 9 të pritshmet (= indeks 0,9 i survejancës nga ai 1,0 i kërkuar);

Ne te njëjtën kohe janë plotësuar kërkesat e tjera, konkretisht:

- raportimi në DKSI (IShP) është bërë në kohë (brenda 3 ditësh nga fillimi i paralizës) në të gjitha rastet;
- secili rast është shoqëruar me 2 mostra feçe të prelevuara në kohë dhe brenda kushteve të kërkuara;
- analiza virologjike e mostrave feçe të prelevuara është përfunduar në kohë në IShP (brenda 28 ditësh nga fillimi i paralizës);
- ndjekja klinike në të gjitha rastet është bërë në kohë (60-90 ditë pas fillimit të paralizës);
- raportimi në Zyrën Rajonale të OBSH (Kopenhagë, Danimarkë) është bërë i plotë (52 javë të vitit) dhe në kohë (çdo javë të vitit).

Të dhënat e vaksinimit OPV në rastet dhe kontaktet e ngushta (familjare) të tyre treguan mbulesë vaksinore 100%.

Të dhënat e analizës virologjike

- hulumtimit epidemiologjik,
- vizitës klinike mbi mbetjen e paralizës deri 90 ditë pas shfaqjes së saj,

konkluduan për mungesë të qarkullimit të poliovirusit të egër në popullatën e vendit tonë.

Importimi i poliovirusit të egër në vendin tonë është i mundshëm në çdo moment. Çka dikton domosdoshmërinë eurvejancës së përforcuar aktive të PFA-ve dhe të realizimit në kohë dhe cilësi të mbulesës vaksinore OPV në nivele >95% jo vetëm në shkallë vendi dhe rrethi, por, dhe sidomos, në nivel “kapilar”, detyra dhe përgjegjësi këto në rradhë të parë dhe mbi të gjitha të shërbimeve epidemiologjike të rretheve.

Rrethet	2017	
	Raste	Incidenca
Berat		
Bulq		
Delvine		
Devoll		
Diber		
Durres		
Elbasan		
Fier	1	0.1
Gramsh		
Gjirokaster		
Has		
Kavaje		
Kolonje		
Korce		
Kruje		
Kucove		
Kukes		
Kurbin		
Lezhe	1	0.2
Librazhd		
Lushnje		
M.MAdhe		
Mallakaster		
Mat		
Mirdite		
Peqin	1	0.4
Permet		
Pogradec	1	0.2
Puke		
Sarande		
Skrapar		
Shkoder		
Tepelene	1	0.5
Tirane	1	0.0
Tropoje		

Vlore	1	0.1
-------	---	-----

Rastet me PFA kane një shtrirje te gjere gjeografike, ne shumicën e rretheve te vendit.

Numri i rasteve dhe incidenca e PFA sipas gjinisë per 2017

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2017	2	0.1	5	0.4

Numri i rasteve dhe incidenca e PFA sipas grupmoshës (2017)

	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
Nr. rasteve me PFA	2	0	5	0	0	0	0
Incidenca	5.5	0	1.2	0	0	0	0

Incidenca me e larte e PFA është ne grupmoshën 1-4 vjeç (5.5 raste 10000 banore).

6. DIFTERIA

Difteria rezulton të jetë 0 (zero raste vjetore). Ky rezultat është një tregues i drejtpërdrejtë i mbulesës optimale vaksinore (>95%) të DTP në radhë të parë, por edhe të rivaksinimeve DTP, DT, dhe Td lidhur si me komponentin (antigenin) difterik, ashtu dhe me komponentët (antigenët) tetanik dhe pertusik.

7. TETANOZI DHE TETANOZ NEONATOR

Tetanozi neonator paraqitet me 0 (zero) raste

Kjo tablo, është një tregues i drejtpërdrejtë i efektivitetit të parandalimit parësor të tetanozit dhe tetanozit neonator nëpërmjet vaksinoprofilaksisë specifike (DTP, DT, Td në moshat pediatrike dhe TT në gratë shtatzëna). Me Tetanoz jo neonator është raportuar vetëm 1 rast i grupmoshës 45-59 vjeç nga rrethi i Tiranës, me një nivel incidence vjetore prej 0.04 raste/10000 banore ne vendi.

8. PERTUS

Më 2017 u raportuan 7 raste të suspektuara klinikisht për pertussis (mosha pediatrike). Viojnë këto, të jenë nivele të papërfillshme të frekuencës së hasjes të sëmundjes në popullatë, duke paraqitur kështu një tablo që pasqyron shkallën optimale të efektivitetit të vaksinoprofilaksisë përkatëse (tri vakcina DTP).

Theksi duhet vënë në *mungesën e konfirmimit laboratorik të rastit*, sepse laboratorët mikrobiologjikë të shëndetit publik të rretheve nuk realizojnë (arsye objektive dhe subjektive) diagnozën mikrobiologjike të pertussis

Pertus numri i rasteve dhe incidenca (raste/100.000) për vitin 2017

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	7	0.2

Frekuenca e hasjes së Pertus paraqet nje nivel incidence prej 0.2 raste/100.000 banorë

Pertus Nr. i rasteve dhe incidenca (raste/10000) sipas rretheve

Rrethet	2001	
	Raste	Incidenca
Berat		
Bulq		
Delvine		
Devoll		
Diber		
Durres	1	0.0
Elbasan		
Fier	1	0.1
Gramsh		
Gjirokaster		
Has		
Kavaje		
Kolonje		
Korce	2	0.2
Kruje		
Kucove		
Kukes		
Kurbin		
Lezhe		
Librazhd		
Lushnje		
M.MAdhe		
Mallakaster		
Mat		
Mirdite		
Peqin		
Permet		
Pogradec		
Puke		
Sarande		
Skrapar		
Shkoder	1	0.1
Tepelene		
Tirane Q	2	0.0
Tropoje		
Vlore		

Numri i rasteve dhe incidenca e Pertus sipas gjinisë për vitin 2017.

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2001	5	0.4	2	0.1

Incidenca e Pertus është pothuajse e njëjte tek te dy gjinitë

Numri i rasteve dhe incidenca e Pertus sipas grupmoshës (2017)

	<1vjeç	1-4 vjeç	5-14 vjeç	15-24 vjeç	25-44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç
Nr. rasteve me Pertus	6	0	0	0	1	0	0
Incidenca	16.6	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0

Incidenca me e larte vërehet ne grupmoshën < 1 vjeç me 16.6 raste/100.000 banore

9. PAROTITI EPIDEMIK

Viti 2005 shënoi vitin e futjes në vendin tonë të vaksinimit të detyrueshëm kundër parotitit epidemik të çdo kohort-lindje të re, vaksinim ky me trivaksinën FRP (Fruth-Rubeolë-Parotit) që vetëkuptohet, ka ndjekur skemën aktuale të vaksinimit kundër fruthit dhe rubeolës (me dyvaksinën FR) dmth doza bazale në moshën 12-15 muaj dhe doza booster (rivaksinimi) në moshën 5-6 vjeç.

Parotiti numri i rasteve dhe incidenca (raste/100000) per vitin 2017.

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	6	0.2

Frekuenca e hasjes së Parotitit paraqet një nivel incidence prej 0.2 raste/100.000 banorë

Parotiti numri i rasteve dhe incidenca (raste/10000) sipas rretheve për 2017.

Rrethet	2017	
	Raste	Incidenca
Berat	0	0
Bulq	0	0
Delvine	0	0
Devoll	0	0
Diber	0	0
Durres	0	0
Elbasan	0	0
Fier	0	0
Gramsh	0	0
Gjirokaster	0	0
Has	0	0
Kavaje	0	0

Kolonje	0	0
Korce	0	0
Kruje	0	0
Kucove	0	0
Kukes	0	0
Kurbin	0	0
Lezhe	0	0
Librazhd	0	0
Lushnje	0	0
M.MAdhe	0	0
Mallakaster	0	0
Mat	0	0
Mirdite	0	0
Peqin	0	0
Permet	0	0
Pogradec	0	0
Puke	0	0
Sarande	0	0
Skrapar	0	0
Shkoder	1	0.1
Tepelene	0	0
Tirane	4	0.1
Tropoje	0	0
Vlore	1	0.1

Numri i rasteve dhe incidenca e Parotitit sipas gjinise

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2017	3	0.2	3	0.2

Incidenca e Parotitit eshte e njejte tek te dy gjinite

Numri i rasteve dhe incidenca e Parotitit sipas grupmoshës (2017)

	<1vjec	1-4 vjec	5-14 vjec	15-24 vjec	25-44 vjec	45-59 vjec	60+ vjec
Nr. rasteve me Parotit	0	1	3	2	0	0	0
Incidenca	0	0.8	0.7	0.4	0	0	0

Incidenca e Parotitit sipas grupmoshës

Incidenca me e larte vërehet ne grupmoshën 1-4 vjeç me 0.8 raste/10000 banore

10. VARICELA

Rastet me varicele hasen kryesisht ne grupmoshën pediatrike 0-14 vjeç dhe ne kolektiva te mbyllura si institucionet parashkollore çerdhe kopshte dhe shkolla ne forme shpërthimesh te kufizuara.

Varicela numri i rasteve dhe incidenca (raste/100000) për vitin 2017.

Vitet	Raste	Raste/100000
2017	2097	74.9

Frekuenca e hasjes së Varicelës paraqet një nivel incidence prej 74.9 raste/100.000 banorë.

Varicela Nr. i rasteve dhe incidenca (raste/10000) sipas rretheve për vitin 2017.

Rrethet	2017	
	Raste	Incidenca
Berat	110	11.2
Bulq	0	0.0
Delvine	0	0.0
Devoll	16	6.0
Diber	5	0.8
Durres	95	4.7
Elbasan	126	6.7
Fier	261	15.8
Gramsh	0	0.0
Gjirokaster	4	1.1
Has	0	0.0
Kavaje	20	3.5
Kolonje	0	0.0
Korce	8	0.7
Kruje	19	3.2
Kucove	119	43.6
Kukes	18	3.8
Kurbin	6	1.3
Lezhe	90	13.7
Librazhd	0	0.0
Lushnje	118	10.0
M.MAdhe	24	7.8
Mallakaster	2	0.7
Mat	47	10.6
Mirdite	0	0.0
Peqin	2	0.8

Permet	1	0.6
Pogradec	39	6.3
Puke	7	3.8
Sarande		0.0
Skrapar		0.0
Shkoder	46	2.8
Tepelene		0.0
Tirane	805	11.6
Tropoje		0.0
Vlore	109	8.6

Numri i rasteve dhe incidenca e Variceles s sipas gjinise

Vitet	Meshkuj	Incidenca	Femra	Incidenca
2001	1085	77.3	1012	72.4

Incidenca e variceles eshte pothuajse e njejte tek te dy gjinitë

Numri i rasteve dhe incidenca e Variceles sipas grupmoshes (2017)

	<1vjec	1-4 vjec	5-14 vjec	15-24 vjec	25-44 vjec	45-59 vjec	60+ vjec
Nr. rasteve me Varicelë	111	716	994	137	136	2	1
Incidenca	307.5	562.0	239.5	26.7	19.2	0.4	0.2

Incidenca me e larte verehet ne grupmoshen 1-4 vjeç me 562.0 raste/100000 banore

11. INFEKSIONET STREPTOKOKSIKE

SKARLATINA DHE ERIZIPELA

